



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT

KUSHTET E VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

Ministria e Pushtetit Lokal ("Autoriteti Kontraktues"),

dhe

INFOSOFT OFFICE SH.P.K. Rr.Tahir Zajmi (kompleksi Kosova Tex), PRISHTINA

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

RI TENDER - Furnizim me Material Shpenzues për BNK – në
LOT – 2

Numri i identifikimit: 212-20-6388-1-3-6 C16

Numri i brendshëm: 212 20 009 136

Ministria e Pushtetit Lokal,

13 Nëntor 2020

Neni 1 Lënda1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **RI TENDER - Furnizim me Material Shpenzues për BNK – në**1.2 Ky furnizim i mallit do të bëhet për **LOT – 2**

Nr.	Titulli	Çmimi për njësi	Çmimi për njësi	Sasia	Njësia matëse	Totali
1	Portable 1TB External Hard Drive HDD me dalje	55.73	55.73	2.00	Copë	111.46
2	Letra A4 80g për fotokopje	2.30	2.30	30.00	Risa	69.00
3	Notesa vetngjithës me ngjyrë 1 100 (76 & 76 mm)	0.16	0.16	30.00	Copë	4.80
4	Heft makinë 24 6 metalike	1.23	1.23	2.00	Copë	2.46
5	Municion për heft makinë 24 6	0.11	0.11	20.00	Kuti	2.20
6	Kapëse teli (paper clips) 45 mm	0.17	0.17	10.00	Kuti	1.70
7	Kapëse teli (paper clips) 78 mm	0.66	0.66	10.00	Kuti	6.60
8	Binder clips (41 mm)	0.78	0.78	10.00	Kuti	7.80
9	Binder clips (51 mm)	1.47	1.47	10.00	Kuti	14.70
10	Binder clips (78 mm)	0.66	0.66	10.00	Kuti	6.60
11	Nënshkruaj këtu "post it" me ngjyra (Page marker arrow) 12 X 45 mm	0.25	0.25	50.00	Komplet	12.50
12	Rafta plastike për dokumente	0.84	0.84	8.00	Copë	6.72
13	Shpuese letrash 1.6 mm	1.29	1.29	2.00	Copë	2.58
14	Shkumë për pastrim ekranësh	1.27	1.27	5.00	Copë	6.35
15	Tabelë me këmbë (flipchart) 70-100	28.34	28.34	1.00	Copë	28.34
16	Letër për flipchart 70x100 1 100 flete 80gr	0.10	0.10	10.00	Copë	1.00
17	Board marker	0.14	0.14	10.00	Copë	1.40
18	Notes A6 me spirale	0.39	0.39	20.00	Copë	7.80
19	Laps - ngjyrë e kaltër 0.5 mm BP	0.20	0.20	30.00	Copë	6.00
20	Markera të përhershëm me ngjyra	0.14	0.14	20.00	Copë	2.80
21	Shportë plastike për mbeturina	1.17	1.17	1.00	Copë	1.17
22	Çkapëse municioni	0.25	0.25	3.00	Copë	0.75
23	Mbështjellës plastik i raporteve me kapëse metalike me ngjyra	0.07	0.07	30.00	Copë	2.10
24	Zarf A4 nga letra me mbyllje	0.03	0.03	30.00	Copë	0.90
25	Tabelë e bardhë e madhe magnetike (60 – 90 cm)	10.25	10.25	1.00	Copë	10.25
26	Push pins –thumba	0.08	0.08	6.00	Kuti	0.48
27	Magneta për tabelë 20 mm	0.33	0.33	6.00	Kuti	1.98
28	Tabelë tape ekonomike (60 – 90 cm)	5.52	5.52	1.00	Copë	5.52
29	Selotejp 18 mm – 18 m	0.13	0.13	5.00	Copë	0.65
30	Scalper	0.14	0.14	2.00	Copë	0.28
31	Gërshërë 21 cm	0.71	0.71	3.00	Copë	2.13
32	Makinë për libërlidhje A4	47.98	47.98	1.00	Copë	47.98

33	Spirale për libërlidhje A4 12mm (transparente)	4.82	4.82	2.00	Kuti	9.64
34	Spirale për libërlidhje A4 22mm (transparente)	12.18	12.18	2.00	Kuti	24.36
35	Kopertinë transparente për libërlidhje A4 high gloss	4.62	4.62	2.00	Copë	9.24
36	Dosje fajlli (folder) A4 5 cm pa kuti me mekanizëm	0.94	0.94	20.00	Copë	18.80
37	Dosje fajlli (folder) A4 7.5 cm pa kuti me mekanizëm	0.94	0.94	20.00	Copë	18.80
38	Mbështjellës kartoni për raporte me A4 me kapëse elastike me ngjyra	0.28	0.28	20.00	Copë	5.60
39	Kablllo vazhduese me 6 priza (5 m)	8.84	8.84	1.00	Copë	8.84
40	Mbrojtës transparent i fletëve A4 me vrima 100 fq	0.78	0.78	20.00	Komplete	15.60
41	Varëse për rroba dhe ombrellë me këmbë për zyrë	17.05	17.05	2.00	Copë	34.10
Totali i përgjithshëm pa TVSH						521.98

1.3 Kontrata hynë në fuqi me datën: 13.11.2020. *Kohëzgjatja e kontratës është 2 muaj.*

Furnizimet do të kryhen menjëher pas nënshkimit të kontratës nga Operatori Ekonomik dhe sipas kërkesës së MPL-së.

1.4 Afati kohor i performances / liferimit nuk mund të jetë më shumë se **[14]** ditë kalendarike nga data e marrjes së urdhërësës.

1.5 Vendi i [dërgimit të furnizimeve] [ekzekutimit të punëve] **[kryerjes së furnizimeve]** do të jetë: **sipas kërkesës së MPL - së nga INFOFT OFFICE SH.P.K.**

1.6 Incotermini i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **521.98 €** [shëno çmimin total në shifra]; Pa TVSH

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Pesëqind e njëzet e një euro e nëntëdhjetë e tetë cent *[shëno çmimin total me shkrim]*. Pa TVSH

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[nëse kontrata përbëhet vetëm nga një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës/mallit pa TVSH]

[nëse kontrata përbëhet nga me shume se një dërgesë shëno]

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[furnizimeve]* *[shërbimeve]* *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[furnizimeve]* *[shërbimeve]* *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]* *[të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet]* *[të kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* *[punëve]* *[shërbimeve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **[Gjykatën Ekonomike në Prishtinë]** në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Adresa e Autoritetit Kontraktues:**Ministria e Pushtetit Lokal,****Ndërtesa e ish "Rilindjes", kati i 12, Salla nr.1220, Divizioni i Prokurimit MPL, Prishtinë****Personi përgjegjës i prokurimit i Autoritetit Kontraktues**Emri dhe Mbiemri: **Shkelzen Hoxha**Titulli: **Z.V Zyrtar përgjegjës i Divizionit të Prokurimit**

Nr. i Tel: + 381 (038) 200 35 614

E-mail: **shkelzen.hoxha@rks-gov.net****Menaxher i proketit nga MPL-ja:**Emri dhe Mbiemri: **Leonora Bajrami**

Titull: Zytare për monitorim të komunave

Nr. i telefonit: 038/ 200 35 662

E-mail: **leonora.bajrami@rks-gov.net****Adresa e Kontraktuesit:****INFOSOFT OFFICE SH.P.K. Rr.Tahir Zajmi (kompleksi Kosova Tex), PRISHTINA****Numri i Biznesit: 810813742****Nr. I llogarisë bankare: 1907541080031149 BKT****Menaxheri i projektit nga Operatori Ekonomik**Emri dhe Mbiemri: **Jeton Alimusaj**

Titulli: Menaxher

Nr. i telefonit: 044 721 003E-mail: **vbytyci@io-ks.com**

E hartuar në gjuhën **Shqipe**² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues: Ministria e Pushtetit Lokal		Operatorin Ekonomik: INFOSOFT OFFICE SH.P.K., Rr.Tahir Zajmi (kompleksi Kosova Tex), PRISHTINË	
Emri:	Shkelzen Hoxha	Emri:	<i>Jeton Alimusaj</i>
Pozita:	Z.V Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	<i>DREKTOR</i>
Nënshkrimi:	<i>Shkelzen Hoxha</i>	Nënshkrimi:	<i>Jeton Alimusaj</i>
Data:	<i>13.11.2020</i>	Data:	<i>13.11.2020</i>
Vula:		Vula:	

InfoSoft Office sh.p.k.

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

